

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioni Rregullator  
Dt.30.11.2020*

30.11.2020

Ora 11:00

RENDI I DITËS

*Projektakti “Për miratimin e ngritjes së Zonave të Administrimit Zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 Prill 2021”.*

## PJESE MARRJA :

- KQZ:
  - Ilirjan CELIBASHI Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
  - Komisioni Rregullator:
  - Ilirjana NANO Kryetar
  - Arens ÇELA Anëtar
  - Dritan CAKA Anëtar
  - Helga VUKAJ Anëtar
  - Muharrem ÇAKAJ Anëtar
  - Stafi KQZ Y.Merkaj, N.Mezini
  - Parti Politike PD, PS, LSI, PDIU
  - Vëzhgues:

**Znj.I.Nano:** Mirëdita, fillojmë mbledhjen e Komisionit Rregulator. Verifikojmë pjesëmarrjen. Janë të pranishëm pesë anëtarët e Komisionit Rregulator. Mbledhja po zhvillohet on-line sikurse është njoftuar më herët, për shkak të situatës së pandemisë dhe në respekt të kufizimeve të vendosura së fundmi për mosorganizimin e eveneteve me më tepër se 10 persona. Në kushtet kur na duhet të kemi edhe të ftuar të tjerë sipas ligjit përfaqësues të partive politike parlamentare, përfaqësues të administratës së KQZ-së, është vlerësuar nga ana jonë që mbledhjet

## *Zbardhi materialin e inçizuar Merita DULAKU*


Wiley

*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioni Rregulator  
Dt.30.11.2020*

të zhvillohen on-line dhe në varësi të situatës të bëjmë vlerësimë të herë pas herëshme. Mbledhja e sotme ka vetëm një pikë të rendit të ditës, pikërisht shqyrtimin dhe miratimin e projektvendimit “Për ngritjen e Zonave të Administrimit Zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 Prill 2021”. Është një detyrim që buron nga Kodi Zgjedhor, ngritja e ZAZ-ve. Është kompetencë e Komisionit Rregulator. Është përgatitur projektakti nga administrata e KQZ-së, pasi janë analizuar të dhënrat e marra nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile. Do të doja që në këtë moment t'i jepja fjalën Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, zotit Ilirjan Celibashi për të prezantuar projektaktin, për të parë ndryshimet që sjell ky projektakt në konfigurimin e zonave të administrimit zgjedhor dhe për të pérmbledhur projektaktin.

**Z.I.Celibashi:** Përshëndetje të gjithëve, sikurse dhe ju zonja Kryetare e përmendët, ky projektakt vjen në përbushje të detyrimeve që ka Komisioni Qendor i Zgjedhjeve për të përcaktuar zonat e administrimit zgjedhor. Neni 27 i Kodit Zgjedhor, paragrafi i pestë i tij përcakton detyrimin e KQZ-së që jo më vonë se 9 muaj para përfundimit të mandatit të Kuvendit, mbi bazën e numrit të shtetasve me të drejtë vote në datën e fundit të periudhës zgjedhore për caktimin e zgjedhjeve, duhet të bëjë kalkulimet për të përcaktuar numrin e shtetasve me të drejtë vote sipas informacionit të dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile. Mbi këtë bazë të bëjë dhe përcaktimin e zonave të administrimit zgjedhor. Ne në përputhje me këto parashikime të Kodit Zgjedhor kemi kërkuar Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile informacion mbi këtë numër shtetasish. Ka ardhur informacioni përkatës nga DPGJC, nga ky informacion ne, sikurse e kemi prezantuar dhe në relacionin përkatës të projektave, rezulton që janë rreth 50 bashki që kanë më pak se 80 mijë shtetas me të drejtë vote. Janë 9 bashki.

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së*

*Komisioni Rregulator*

*Dt.30.11.2020*

Bashkia: Shkodër, Lezhë, Durrës, Kamëz, Tiranë, Elbasan, Lushnje, Korçë edhe Vlorë të cilat kanë më shumë se 80 mijë zgjedhës me të drejtë vote. Në këto bashki ekziston ndarja e zonavë të administrimit zgjedhor në përputhje me kriterin që ka përcaktuar Kodi Zgjedhor, pra kanë më pak se 80 mijë shtetas me të drejtë vote. Rezulton vetëm për bashkinë Berat dhe Fier ky numër më i lartë se 80 mijë. Për këtë arësy ne kemi propozuar që për Bashkinë e Beratit dhe Bashkinë e Fierit të cilat kanë mbi 80 mijë shtetas me të drejtë vote të bëhet ndarja në dy zona të administrimit të zgjedhjeve sipas edhe atyre kritereve të cilat ligji i ka përcaktuar duke respektuar vazhdimësinë gjeografike dhe shtrirjes në të njejtin territor. Projektin ne e kemi paraqitur për secilin rast dhe mendojmë që ky projekt reflekton respektim të plotë të atyre kërkesave të ligjit për ndarjen e zonave të administrimit të zgjedhjeve, faleminderit!

**Znj.I.Nano:** Faleminderit zoti Celibashi, çelim diskutimin në parim të projektvendimit. Së pari u drejtohem kolegëve anëtarë të Komisionit Rregulator dhe më tej përfaqësuesve të partive politike parlamentare. Për hir të transparencës duhet thënë që u është kërkuar mendim si dhe i është dërguar projektakti më herët. Zyrtarisht nuk kanë sjellë asnjë mendim, propozim, sugjerim të ndryshëm nga ai ç'ka përmban projektakti që po shqyrtojmë sot. Të nderuar kolegë, anëtarë të Rregulatorit nëse do të donit të thonit diçka në lidhje me projektaktin në kuadër të diskutimit në parim? Po zoti Çakaj!

**Z.M.Çakaj:** I nderuar Komisioner, e nderuar Kryetare, siç kemi folur javën e kaluar dhe në vijim, unë kam bërë një kërkesë që të ishin prezent përfaqësues të DPGJC. Së pari, kisha dy pyetje për përfaqësuesit e DPGJC. Nuk e di me sa duket çështje aksesi, çështje mos njoftimi, gjithësesi unë kam dy pyetje. Pyetja e parë


*Zbardhi materialin e inçizuar  
Merita DULAKU*



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioneri Rregulator  
Dt.30.11.2020*

konsiston në faktin cila është metodologjia që ka përdorur DPGJC lidhur me identifikimin e të dhënavëve dhe sigurisht për përpunimin e materialeve për të përcaktuar zonat zgjedhor siç është dhe kufiri i parashikuar në Kodin Zgjedhor mbi 80 mijë zgjedhës në një zonë zgjedhore? Së dyti, dua të ndaj dhe me ju që sigurisht do të kemi dhe akte në vijim, por kam një kërkesë të veçantë dhe për Komisionerin që në një mbledhje sa më të afërt të mundësojë prezencën e përfaqësuesve të DPGJC lidhur me një problematikë të shfaqur së fundmi. Siç është artikuluar dhe në media këtë problematikë e kemi hasur dhe në familjet tona, me të afërmit tanë. Ka ndodhur dhe po ndodh një fenomen i tillë. Gjendja civile.. dmth njësia administrative ku familje të ndryshme janë regjistruar, por rezultojnë dhe figurojnë në Tiranë. Ndërkohë anëtarë të tjerë të familjes rezultojnë të regjistruar në qarqe, apo bashki të ndryshme. Së pari do të doja të pyesja përfaqësuesin e DPGJC si ka mundësi kjo? Se në Ligjin “Për Gjendjen Civile” normalisht parashikohet që vetë banuesi në një njësi administrative, qark apo bashki të caktuar, së pari zgjedh lirisht vendbanimin e tij dhe sigurisht që ka disa kriterë. Qoftë nëpërmjet kriterit të pronësisë, apo një kontrate qeraje. Dmth a kemi të bëjmë këtu me një transformim të vullnetit të banuesit, ose një ndërhyrje në vullnetin e gjithësecilit për të zgjedhur vendbanimin. E para kjo, e dyta cili është kriteri që këta votues, sigurisht që kjo mund t'i impaktonte dhe nuk e di nëse do t'i impaktonte apo jo, prandaj duhet të ishin përfaqësuesit e DPGJC., a i impakton kjo zonat zgjedhore dhe së dyti në merakun tonë që është kryesorë në fletën e votimit dhe në ditën e votimit. Të gjithë e dimë që në ditën e zgjedhjeve dhe në qendrën e votimit secili prej zgjedhësve dhe votuesve duhet të ketë me vete një dokument identifikimi. Duke marrë në konsideratë faktin që gjithë sistemi i identifikimit biometrik, sistemi i paisjes me dokumente biometrike ka nisur diku nga fundi i vitit 2008, 2009, 2010 kemi një numër të konsiderueshëm zgjedhësish të cilëve u ka mbaruar dokumenti i

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Merita DULAKU*



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së*

*Komisioneri Rregulator*


*Dt.30.11.2020*

identifikimit dhe në këtë kohë të pandemisë i bie që janë me dokument të skaduar. Pavarësisht urdhërit, apo aktit nënligjor që ka nxjerrë ministri i brendshëm i bie që një pjesë e konsiderueshme, do të doja ta kishim këtë informacion nga përfaqësuesit e DPGJC, janë në proces rinvimi. Ndërkohë ta strukturoj fjalinë, a e impakton kjo në ditën e votimit, në momentin e votimit një zgjedhës i cili realisht figuron i regjistruar në Tiranë, por nuk shkon në qendrën e votimit për arësyen se nuk ka dokumentin e identifikimit se duhet ta marrë në Tropojë, Lushnje, Konispol apo kudo që e ka hedhur gjendja civile. Në këto kushte unë po ndaj me ju një shqetësim dhe do të doja që në një mbledhje sa më të afërt të kishim prezent drejtues, apo përfaqësues kryesisht të nivelit drejtues të DPGJC të na sqaronin për këtë fakt, faleminderit e nderuar!

**Znj.I.Nano:** Faleminderit zoti Çakaj, bashkohem me shqetësimin tuaj. Lidhur me pyetjen e parë, unë mendoj se administrata e KQZ-së përkatësisht Drejtori i IT-së që është prezent në mbledhje mundet të na sqarojë lidhur me metodologjinë për hartimin e këtij vendimi pasi të dhënat janë përfshuar nga gjendja civile, vendimi është hartuar nga administrata e KQZ-së. Sa për kërkesën tuaj lidhur me praninë në një mbledhje të afërt të përfaqësuesve të nivelit të lartë të DPGJC, sikundër besoj se të gjithë kanë dijeni, e kemi trajtuar më herët këtë çështje. Ndoshta sot është mbledhja e parë on-line dhe kemi ato vështirësitë teknike, por pajtohem me ju që këto shqetësime t'i bëjmë prezent qoftë në një mbledhje publike, qoftë nëpërmjet kërkimit të një informacioni zyrtar nga ana e përfaqësuesve të gjendjes civile, qoftë edhe për faktin që një pjesë e dokumenteve biometrike të identifikimit janë duke skaduar. Pra, të kemi një informacion sa më të gjerë lidhur me këtë çështje, sa më të saktë në rradhë të parë. Nuk e di nëse Komisioneri ka diçka me ato që diskutuat ju më sipër zoti Çakaj, nuk e di...

*Zbardhi materialin e inçizuar*

*Merita DULAKU*




*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioni Rregulator  
Dt.30.11.2020*

**Z.I.Celibashi:** Duhet të kuptojmë që ne në lidhje me këtë projektakt, raporti ose më mirë marrëdhënia ndërmjet KQZ-së dhe DPGJV është si vijon: ne kërkojmë informacion për numërin e shtetasve me të drejtë vote dhe ata sjellin këtë informacion. Pra, në kuptim të numërit unë besoj se ajo si e dhënë e ardhur nga DPGJC është e saktë dhe nuk besoj se kemi dyshime për këtë. Se si DPGJC ka shkuar tek ky numër, ajo ç'ka ka shqetësim zoti Çakaj, unë mbajta shënim dhe në cilësinë e përfaqësuesit të KQZ-së në marrëdhënie me të tretët do t'i kërkoj një informacion DPGJC në lidhje me lëvizjet e fundit dhe kriteret mbi të cilat janë bërë lëvizjet e shtetasve nga një regjistër i gjendjes civile të një njësie vendore në tjetrin. Kur të jetë rasti, në mbledhjen përkatëse të Rregulatorit mendoj se mund t'i ftojmë përfaqësuesit e DPGJC në cilësinë e përfaqësuesve të shtetit që mund të jepin informacion që mund të jetë ndihmues për KQZ-në për miratimin e aktit përkatës. Gjithësesi shkurt në ditët në vijim ne po e adresojmë kërkesën për të marrë informacionin për të cilin zoti Çakaj e konsideron të dobishëm, por edhe për akte të tjera që lidhen me numërin e shtetasve me të drejtë vote. Por për të qartësuar edhe njëherë numëri mbi të cilin ne jemi bazuar për të përgatitur këtë akt nuk besoj se ka dyshime, faleminderit!

**Znj.I.Nano:** Faleminderit! Po ju drejtohem dhe njëherë kolegëve të tjere në qoftë se kanë diçka në parim në lidhje me projektakin? Përfaqësuesit e partive parlamentare, kanë diçka me projekakin në parim?

**Z.L.Nuraj, përfaqësues i Partisë Demokratike:** Aktin e kemi parë dhe jemi njohur me të. Në tërësinë e tij shprehemi dakord në parim, nuk kemi asgjë.

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioni Rregulator  
Dt.30.11.2020*

**Znj.I.Nano:** Faleminderit zoti Nuraj! Unë në vijim të diskutimeve të sa po mbyllura deri tani do të doja të theksoja rëndësinë e përpunimit të informacionit që ka ardhur nga DPGJC dhe shtimin e KZAZ-ve nga 90 në 92. Gjë e cila në diskutimet tona të mëhershme gjatë shqyrtimit të këtij projektakti përvëç se e kemi konsideruar një detyrim që buron nga ligji në raport me numrin 80 mijë zgjedhës, pra jo më shumë se 80 mijë shtetas me të drejtë vote në një KZAZ e kemi konsideruar dhe një mundësi më të mirë për një numërim më të shpejtë të votave. Ajo ç'ka doja unë të theksoja është fakti që do të rinumërtohen KZAZ-të duke filluar me numërin dyshifror nga 01 deri tek 92. Më lejoni atëherë të mbyll diskutimet në parim dhe të ftoj anëtarët e Komisionit Rregulator për të votuar në parim projektvendimin. Duke qenë se jemi on-line do të doja që secili prej nesh të shprehet me votën pro ose kundër. Atëherë çel votimin në parim.

**Kush është dakord?**

**Pro:** 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)


**Kundër:** S'ka

Miratohet në parim projektvendimi “Për miratimin e ngritjes së Zonave të Administrimit Zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 Prill 2021”. Fillojmë diskutimin pikë për pikë. Personalisht kam një propozim. Projekti që na ka ardhur e ka titullin “Për miratimin e ngritjes së Zonave të Administrimit Zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 Prill 2021”. Unë kam propozimin “Për ngritjen e Zonave të Administrimit Zgjedhor...” në fakt vendimin në fund të fundit e miratojmë. Nuk e di nëse kolegët kanë ndonjë propozim duke filluar që nga titulli. Pra, propozimi im është që titulli të jetë: Vendim “Për ngritjen e Zonave të Administrimit Zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 Prill 2021”.

**Kush është dakord?**

**Pro:** 5 (znj.Nano, znj.Vukaj, z.Çaka, z.Çakaj, z.Çela)

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioni Rregulator  
Dt.30.11.2020*

**Kundër:** *S'ka*

Miratohet!

Atëherë unë nuk po lexoj gjithshka Komisioneri parashtroi. Kemi tre pikat të projektvendimit që Komisioni Rregulator do të miratojë.

**Pika 1.** Të miratojë ngritjen e 92 (nëntëdhjetë e dy) Zonave të Administrimit Zgjedhor për Zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 prill 2021, sipas lidhjes nr. 1.

**Kush është dakord?**

**Pro:** *5 (zpj.Nano, zpj.Vukaj, z.Çaka, z.Çakaj, z.Çela)*

**Kundër:** *S'ka*

Miratohet!

**Pika 2.** Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Kush është dakord?**

**Pro:** *5 (zpj.Nano, zpj.Vukaj, z.Çaka, z.Çakaj, z.Çela)*

**Kundër:** *S'ka*

Miratohet!

**Pika 3.** Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

**Kush është dakord?**

**Pro:** *5 (zpj.Nano, zpj.Vukaj, z.Çaka, z.Çakaj, z.Çela)*

**Kundër:** *S'ka*

Miratohet!

Unë do të shtoja tek pika 2 “Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së”. Secili vendim i yni publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së.

**Kush është dakord?**

**Pro:** *5(zpj.Nano, zpj.Vukaj, z.Çaka, z.Çakaj, z.Çela)*

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Merita DULAKU*



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së  
Komisioni Rregulator  
Dt.30.11.2020*

**Kundër:** *S'ka*

Miratohet!

Përderisa përfaqësuesit e partive parlamentare nuk kanë pasur ndonjë diskutim, sugjerim për projektvendimin, as në parim e as për pikat të veçanta të tij, ju ftoj ta votojmë në tërësi aktin me dy ndryshime të propozuara një në titull dhe një në pikën 2.

**Kush është dakord?**

**Pro:** *5(znj.Nano, znj.Vukaj, z.Çaka, z.Çakaj, z.Çela)*

**Kundër:** *S'ka*

**Miratohet** me pesë vota pro vendimi “Për ngritjen e Zonave të Administrimit Zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 Prill 2021”. Të nderuar kolegë, duke qenë se kjo ishte e vetmja pikë në rendin e ditës, por mjaft e rëndësishme mendoj, që ka marrë një kohë të gjatë për shqyrtimin deri tani dhe e mbyllëm me sukses. Unë e deklaroj mbledhjen të mbyllur, Mirë u takofshim!

**Vendimi nr.6**

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Merita DULAKU*

